

D E K R E T
Nr.7452, datë 5.1.1991

PËR KRIJIMIN E KOMITETIT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Nisur nga rëndësia që kanë problemet e mbrojtjes së mjedisit dhe me qëllim që të forcohet organizimi e drejtimi i punës në këtë fushë,

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Krijimi i Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit, si organ kolegjal e vendimor në varësi të Këshillit të Ministrave.

Neni 2

Detyrat dhe të drejtat e Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
Sihat Tozaj

KRYETARI
Ramiz Alia